

Kurset e integrimit

Çfarë është kursi i integrimit?

Kursi i integrimit është i përberë nga një kurs i gjuhës me 600 orë mësimi dhe një kurs i orientimit me 60 orë mësimi. Kursi i gjuhës përbëhet nga disa seksione, secili me përkatësisht 100 orë mësimi. 300 orët e para të mësimit quhen kursi bazë i gjuhës, kurse 300 orët në vazhdim vlejné si kursi i avancuar.

Në kursin e gjuhës ju do të mësoni fjalorin, i cili iu nevojitet për të folur dhe shkruar në jetën e përditshme. Këtu hyjnë kontakti me institucionet zyrtare, bisedat me fqinjët dhe kolegët e punës, shkrimi i letrave si edhe plotësimi formularëve.

Kursi i orientimit iu informon mbi jetën në Gjermani dhe iu ofron njohuri mbi sistemin ligjor, kulturën dhe historinë aktuale të Gjermanisë.

Ekzistojné edhe forma tjera specifike të kurseve të integrimit si p.sh. për gratë, prindërit, të rinjtë si edhe për personat, të cilët nuk mundën të shkruajnë dhe të lexojné siç duhet. Këto kurse zgjasin 960 orë mësimi. Në qoftë se ju mësoni veçanërisht shpejt, atëherë ju mund të ndiqni një kurs intensiv, i cili përbëhet nga një kornizë prej 430 orë mësimi.

Bartësi i kursit para se të filloni kursin, me anë të një testi e përcakton, se për cilin kurs jeni më i përhtatshëm.

Kush mund të marr pjesë në kursin e integrimit?

Dallimi bëhet mes:

- Imigrantëve, të cilët kanë marrë një leje-qëndrimi para 01.01.2005
- Imigrantëve, të cilët kanë marrë një leje-qëndrimi pas 01.01.2005
- Shtetasve të BE
- Të riatdhesuarve (Spätaussiedler)
- Shtetasve gjermanë
- Personave me leje-qëndrimi të toleruar (Geduldeten) për shumë vite
- Shtetasve me të drejtë rezidence afatgjatë të vendeve të treta

Të riatdhesuarit përgjithësisht kanë të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integrimi.

Imigrantëve, të cilët kanë marrë një leje-qëndrimi para 01.01.2005, si edhe shtetasit e BE dhe ata me nënshtetësi gjermane nuk e kanë të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integrimi. Megjithatë, ju mund të lejoheni të merrni pjesë në kursin e integrimit në rrethana apo kushte të caktuara. Edhe personat me leje-qëndrimi të toleruar (Geduldete), nëse plotësojnë kushtet e parashtruara në nenin § 104 a të Ligjit për Rezidencën (AufenthaltG) mund të marrin pjesë.

Imigrantët, të cilët kanë marrë një leje-qëndrimi pas 01.01.2005, kanë të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integrimi, nëse ata nuk zotërojnë njohuri të mjaftueshme mbi gjuhën gjermane. Me hyrjen në fuqi të ligjit për zbatimin e udhëzimeve, shtetasit me të drejtë rezidence afatgjatë të vendeve të treta, fitojné gjithashtu të drejtën e pjesëmarrjes në një kurs integrimi, nëse mund të vërtetojnë rezidencën për më tepër se pesë vjet, në një nga shtetet e BE-së.

Për grupet e ndryshme të imigrantëve, vlejné rregulla të ndryshme.

Kush është i detyruar të marr pjesë në kursin e integritit?

Të huajt, të cilët e kanë marrë leje-qëndrimin para 01.01.2005, mund të jenë të detyruar të ndjekin kursin, nëse ata marrin pagesën e papunësisë (Arbeitslosengeld II) apo nëse ata kanë nevojë të veçantë për integrim (si p. sh. fëmijët e mitur).

Nënshtetasit gjerman, të riatdhesuarit dhe shtetasit e BE-së nuk mund të detyrohen të marrin pjesë në një kurs integrimi.

Të huajt, të cilët e kanë marrë leje-qëndrimin pas 01.01.2005, mund të jenë të detyruar të ndjekin kursin, nëse ata nuk janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë të thjeshtë apo të mjaftueshme në gjuhën gjermane. Vendimi për këtë varet nga statusi i leje-qëndrimin në Gjermani.

Sa kushton kursi i integrimi?

Ju duhet t'i paguani bartësit të kursit një tarifë prej 1,20 EUR për çdo orë mësimi. Kjo tarifë duhet të paguhet në fillim të çdo seksioni të kursit.

Nëse pagesa e kësaj tarife është e vështirë për ju, për arsye të të ardhurave të ulëta, ju mund të parashtroni një kërkesë me shkrim për lirimin nga këto shpenzime, pranë zyrës përkatëse rajonale të Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatë.

Regjistrimi për pjesëmarrjen në një kurs integrimi:

Nëse ju keni të drejtën apo jeni të detyruar të merrni pjesë në një kurs integrimi, do të informoheni mbi këtë me anë të një konfirmimi me shkrim nga zyra e të huajve apo nga zyra përkatëse për pagesën e papunësisë (Arbeitslosengeld II). Njëkohësisht do të merrni edhe një listë me bartësit e kurseve, të cilët ofrojnë kurse integrimi në afërsi të vendbanimit tuaj.

Ju lutemi të regjistroheni menjëherë pas marrjes së dokumenteve obliguese, të një nga bartësit e kursit të zgjedhjes suaj dhe dërgoni menjëherë, jo më vonë se katër javë, regjistrimin për pjesëmarrjen në një kurs integrimi zyrës së të huajve.

Pjesëmarrja e rregullt në kurs:

Në mënyrë që të arrini qëllimin e kursit të integritit, ju duhet të merrni pjesë rregullisht në kurs. Kjo do të thotë, që ju duhet ta vizitoni rregullisht kursin dhe të merrni pjesë në provimin përfundimtar. Pjesëmarrja e rregullt në kurs është për ju gjithashtu e rëndësishme, nëse juve u paguhen shpenzimet e rrugës ose dikur do të dëshironi të përsërisni orë mësimi të kursit të gjuhës. Bartësi i kursit mund të konfirmoj pjesëmarrjen tuaj të rregullt me shkrim, nëse ju e dëshironi këtë.

Ndërrimi i bartësit të kursit, është parimisht i mundur vetëm pas mbylljes së një seksioni të kursit.

Pjesëmarrja në testin përfundimtar:

Testi përfundimtar përbëhet prej testit të gjuhës dhe testit të mbi kursin e orientimit. Në qoftë se ju dëshmoni njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes në testin e gjuhës dhe e kaloni testin e orientimit, atëherë ju e keni përfunduar me sukses kursin e integritit dhe merrni certifikatën e kursit të integritit «Zertifikat Integrationskurs».

Ajo dëshmon kompetencat gjuhësore të nivelit B1 sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (KPER).

Në qoftë se nuk jeni të suksesshëm, do të merrni një vërtetim mbi rezultatin e arritur.

Pjesëmarrja në testin përfundimtar është falas.

Përsëritja e kursit të përparuar:

Në qoftë se ju nuk arrini të dëshmoni njohuri të mjaftueshme të gjermanishtes në testin e gjuhës, ju mund të përsërisni edhe vetëm për një herë deri në 300 orë të kursit të gjuhës si edhe të përsërisni edhe një herë falas testin e gjuhës. Megjithatë, kusht është, që ju të keni marrë pjesë rregullisht në mësim.

Për pjesëmarrjen në kursin alfabetizimit, nuk është e nevojshme pjesëmarrja në kursin e gjuhës.

Për pjesëmarrjen në përsëritjen e kursit, ju duhet të bëni një kërkesë pranë zyrës përkatëse rajonale të Zyrës Federale për Migracion dhe Refugjatë.

Udhëzime mbi pjesëmarrjen e detyruar në kursin e integrimin:

Në qoftë se ju jeni të detyruar, prej zyrës së të huajve apo prej zyrës përkatëse për pagesën e papunësisë (Arbeitslosengeld II), të merrni pjesë në një kurs integrimi, ju duhet të regjistroheni sa më parë të jetë e mundur në një kurs dhe ta ndiqni atë rregullisht.

Nëse ju nuk e bëni këtë, kjo mund të ketë ndër të tjera pasojat e mëposhtme:

- mund të ndikoj në vendimin për vazhdimin e leje-qëndrimit
- në rast se ju merrni mbështetje sociale, këto përfitime mund të shkurtohen
- sipas rastit, ju mund të detyroheni nga zyra e të huajve të paguani shumë më plotë paraprakisht për tarifën prej 1,20 EUR për orë mësimi, të të gjithë kursit të integrimin.
- mund të iu ngritet një gjobë

Bartësi i kursit duhet të informoj zyrën e të huajve ose zyrën përkatëse të Arbeitslosengeld II, nëse ju nuk e ndiqni rregullisht kursin e integrimin.

Për sa kohë kursi i integrimin nuk është i suksesshëm dhe nuk mbyllet në mënyrë të rregullt, vazhdimi i leje-qëndrimit mund të bëhet vetëm për një vit.

Informacione tjera:

Të gjithë formularët e aplikimit të përmendura në këtë broshurë do t'ju ofrohen nga bartësi i kursit, te zyra juaj e të huajve ose te zyra përkatëse rajonale e Zyrës Federale.

Zyra juaj përkatëse rajonale:

Bundesamt für Migration und Flüchtlinge (Zyra Federale për Migracion dhe Refugjatë)

Boschetsrieder Straße 41

81379 München

Tel.: 089 62029-0

Fax: 089 62029-199

Informacione tjera, formularë dhe broshura mund t' i gjeni këtu:

<http://www.bamf.de/DE/Willkommen/DeutschLernen/Integrationskurse>

Lista me bartësit e kursit në Qarkun (Landkreis) Freising:

Emri i bartësit	Rruga	Nr. I Postes	Vendi	Telefon
-----------------	-------	--------------	-------	---------

Shkolla e lartë VHS Freising e.V.	Kammergasse 12 prej 01.07.2011	85354	Freising	08161-490744
CBZ Freising GmbH	Erdinger Str. 84	85356	Freising	08161 84610

Shkolla e lartë popullore VHS Moosburg e.V.	Stadtplatz 2	85368	Moosburg	08761-7225-12
Shkolla e lartë popullore VHS Moosburg e.V.	Stadtplatz 2	85368	Moosburg	08761-7225-12
Shkolla e lartë popullore VHS Moosburg e.V.	Stadtplatz 2	85368	Moosburg	08761-7225-12
Shkolla e lartë popullore VHS Moosburg e.V.	Stadtplatz 2	85368	Moosburg	08761-7225-12
Akademia gjermane e nëpunësve Deutsche Angestellten-Akademie GmbH DAA	Landwehrstr. 73/75	80336	München/Mynih	089-54430233

Instituti i gjuhëve Alterlingua	Hunoldsgraben 35	86150	Augsburg	0821-3463422
---------------------------------	------------------	-------	----------	--------------